



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Municipality Dragas
Zyra e Kryetarit/Kancelarija Predsednika/President office

Komuna e Dragashit / Komisioni i formuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Dragashit, 01nr.060/01-4101/24-2, datës së 29.02.2024, në bazë të nenit 5, 6. pika 1. Paragrafi 3 dhe neni 15 i Ligjit 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, dhe në bazë të nenit 10,14,15 të Rregullores së QRK-së nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurës për dhënien në shfrytëzim dhe shkëmbimin e patundshmëri komunale, në pajtim me vendimin preliminar të Kuvendit të Komunës për shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale 060/01-4101/24-1 të datës 29.02.2024, më 09.07.2024, shpall:

NJOFTIM PUBLIK

për shprehjen e interesit publik për dhënien e pronës së paluajtshme komunale për shfrytëzim afatgjatë

Objekti i njoftimit të shprehjes publike të interesit:

- **Dhënie në shfrytëzim afatgjatë** të parcelës kadastrale P-70604038-00244-4 ZK Shajne , në vendin e quajtur “Dubarava –Mejdan-Dubrava” , (rruga deri tek parcela, kyçja në rrjetin elektrik është e siguruar);
- **Sipërfaqja : 12 500m²;**
- **Qëllimi/ veprimtaria:** (veprimtari bujqësore lidhur me pemëtarin, grumbullimin dhe ruajtjen dhe përpunimin e frutave, bimëve mjekësore, etj.)
- **Afati i shfrytëzimit: 35 vite** (tridhjetë e pesë vjet) nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes për dhënien në shfrytëzim...
- **Oferta fillestare: 750 €** (me fjalë "shtatqindespdhijeteuro")vjetorë.

KRITERET, AFATET, PROCEDURAT, KUSHTET

- Kriter – **Oferta më e lartë e ofruar ;**
- Afati për dorëzimin e ofertave: - **brenda 15 ditëve nga postimi i njoftimit në webfaqen e Komunës, gjegjësisht në mediat publike, në tabelën e shpalljeve të Komunës së Dragashit, pra prej datës 09.07.2024 dhe zgjat deri më 24.07 2024 si afat i fundit për dorëzimin e ofertave.**
- Përmbajtja e ofertës: **emërtimi i një personi juridik ose fizik se është i interesuar për ta marrë pronën e paluajtshme të përshkruar më sipër, një çmim të përcaktuar qartë, një përshkrim i shkurtër i veprimtarisë që do të kryhet, numri i kontaktit dhe adresa e personit të interesuar.**
- Ofertat për shfrytëzimin e ngastrës së lartpërmendur mund të dorëzohen nga të gjithë personat fizikë ose personat e tyre të autorizuar dhe personat juridikë ose personat e autorizuar ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar. Nëse bëhet fjalë për kompani/biznes apo ndërmarrje, licenca është e detyrueshme.
- **Dorëzimi i ofertave:** Ofertat në zarfe të mbyllura dorëzohen përmes shërbimit të pranimit të komunës së Dragashit, drejtuar Komisionit për Vlerësimin e dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës së Dragashit. Ofertat dorëzohen pa pagesë. Ofertës duhet ti bashkangjitet një vërtetim të lëshuar nga Drejtoria e Financave, se ofertuesi nuk ka borxhe ndaj Komunës.
- **Hapja e ofertave do të bëhet më datën 29.07.2024 në sallën e Kuvendit Komunal në ora 10:00,** është i mundshëm ndryshimi i zyrës në bazë të nevojës.
- Formularët e ofertës mund të merren në shërbimin e pranimit të komunës së Dragashit.



PËRKUFIZIMET

Asnjë ofertë nuk do të merret parasysh apo pranohet, pavarësisht nga çmimi i ofruar nëse:

1. Ofertuesi nuk ka paraqitur dëshmi të lëshuar nga Drejtoria e Financave se nuk ka borxhe ndaj komunës së Dragashit, në bazë të taksave apo detyrimeve tjera;
2. Nëse i referohet aktiviteteve që lëshojnë tym, pluhur dhe kimikate të tjera rrezikshme ose të dëmshme;
3. Veprimtaritë që lidhen me përpunimin e gurit, prodhimin e materialit ndërtimor etj.
4. Nëse i referohet veprimtarive të ndaluara me ligj.

TË DREJTAT E PJESËMARRËSVE NË PROCEDURËN E DHËNIES NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PASURISË SË PALUAJTSHME KOMUNALE DHE TËRHEQJE E OFERTËS

- Personi fizik apo juridik/ofertues i interesuar ka të drejtë të informohet për procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë, të ketë akses në dokumentacionin kadastral dhe pronësor në lidhje me parcelën dhe qasje fizike në të për inspektim.

Çdo ofertues mund të tërhiqet nga procedura e marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, pra të tërhiqet nga oferta jo më vonë se 3 ditë para hapjes së ofertave. Tërheqja bëhet me shkrim përmes shërbimit të pranimit të komunës së Dragashit. Mosparaqitja e ofertuesve në hapjen e ofertave nuk do të konsiderohet tërheqje nga ankandi publik.

Ky njoftim do të publikohet në webfaqen zyrtare të komunës së Dragashit në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren e lartpërmendur; në tabelën e shpalljeve të Komunës dhe të paktën në një nga mediat elektronike.

Nr. kontaktues: 044 390 825

KRYETAR I KOMUNËS

Dr. Bexhet Xheladini

